



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 24	2000	Gusht
---------------	-------------	--------------

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8648, datë 28.7.2000	Për ratifikimin e "Protokollit të Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregisë"	1239
Ligj nr.8649, datë 28.7.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjeve të Rezolutave të Raundit të Uruguait për Negociatat Shumëpalëshe Tregtare"	1241
Ligj nr.8650, datë 28.7.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8114, datë 28.3.1996 "Për Sportin"	1242
Ligj nr.8651, datë 28.7.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998, "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999', nr.8552, datë 18.11.1999 dhe nr.8581, datë 17.2.2000	1243
Ligj nr.8654,	Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës	1245

datë 31.7.2000

Ligj nr.8655, datë 31.7.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"	1249
Ligj nr.8656, datë 31.7.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999	1256
Ligj nr.8657, datë 31.7.2000	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.1, datë 14.7.2000 "Për një ndryshim në ligjin nr.8554, datë 10.12.1999 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2000"	1259
Ligj nr.8658, datë 31.7.2000	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.2, datë 27.7.2000 "Për miratimin e fondit për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor"	1260
Vendim i KM Nr.434, datë 4.8.2000	Për strehimin e familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që banojnë në shtëpi, ish-pronë private, dhe për familje të pastreha të invalidëve	1261

L I G J
Nr.8648, datë 28.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN E MARRAKESHIT, QË THEMLOI ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGTISË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Marrakeshit, që themloi Organizatën Botërore të Tregtisë””, sipas materialeve përbërëse si më poshtë:

1. Raporti i Grupit të Punës për anëtarësimin në OBT.
2. Skeduli koncensionëve dhe angazhimeve në mallra.
3. Skeduli i angazhimeve specifike në shërbime.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2719, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

PROTOKOLL
I ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË MARRËVESHJEN E MARRAKESHIT
QË THEMLOI ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGTISË

Organizata Botërore e Tregtisë (e quajtur këtej e tutje “OBT”) në vijim të miratimit të Këshillit të Përgjithshëm të OBT-së i marrë në bazë të Nenit XII të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themloi Organizatën Botërore të Tregtisë (e quajtur këtej e tutje “Marrëveshja e OBT-së”) dhe Republika e Shqipërisë (e quajtur këtej e tutje “Shqipëria”),

Duke u bazuar në Raportin e Grupit të Punës për Anëtarësimin e Shqipërisë në OBT në dokumentin WT/ACC/ALB/SPEC/6/Rev.4 (i quajtur këtej e tutje “Raporti i Grupit të Punës”),

Duke pasur parasysh rezultatet e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në OBT,
Bien dakord si më poshtë:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Protokolli, Shqipëria pranohet në Marrëveshjen e OBT-së sipas Nenit

XII të kësaj Marrëveshjeje dhe, në këtë mënyrë, bëhet anëtare e OBT-së.

2. Marrëveshja e OBT-së në të cilën pranohet Shqipëria do të jetë Marrëveshja e OBT-së e korrigjuar, e përmirësuar ose e modifikuar nga instrumente ligjore të tilla që mund të kenë hyrë në fuqi përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Ky Protokoll, i cili do të përfshijë angazhimet e përmendura në paragrafin 167 të Raportit të Grupit të Punës, do të jenë pjesë përbërëse e Marrëveshjes së OBT-së.

3. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në paragrafët e përmendur, në paragrafin 167 të Raportit të Grupit të Punës, obligimet në Marrëveshjet Tregtare Multilaterale që i janë aneksuar Marrëveshjes së OBT-së dhe që duhen implementuar për një periudhë kohe që fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen nga Shqipëria në atë mënyrë që ajo do ta kishte pranuar këtë Marrëveshje në datën e hyrjes së saj në fuqi.

4. Shqipëria mund të ruajë ndonjë masë që nuk pajtohet me paragrafin 1 të nenit II të Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë në Shërbime (GATS), me kusht që kjo masë të jetë regjistruar në listën e Përgjashtimeve nga Neni II, që i është aneksuar këtij Protokoll dhe që plotëson kushtet e Aneksit të GATS-it për Përgjashtimet nga Neni II.

PJESA II SKEDULET

5. Skedulet që i janë aneksuar këtij Protokoll do të quhen Skeduli i Koncesioneve dhe i Angazhimeve që i është aneksuar Marrëveshjes së Përgjithshme Për Tarifat dhe Tregtinë 1994 (e quajtur këtej e tutje “GATT 1994”) dhe Skeduli i Angazhimeve Specifike që i është aneksuar Marrëveshjes së Përgjithshme Për Tregtinë në Shërbime (e quajtur këtej e tutje “GATS”) që kanë të bëjnë me Shqipërinë. Afati i koncesioneve dhe i angazhimeve të renditura në Skedulet do të zbatohet siç është përcaktuar në pjesët përkatëse të Skeduleve respektive.

6. Për qëllime reference lidhur me datën e kësaj Marrëveshjeje, përmendur në paragrafin 6(a) të Nenit II të GATT-it 1994, data e zbatimit në lidhje me Skedulet e Koncesioneve dhe të Angazhimeve që i janë aneksuar këtij Protokoll, do të jetë data e hyrjes në fuqi e këtij Protokolli.

PJESA III DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7. Ky Protokoll do të jetë i hapur për pranim nga Shqipëria deri më 31 dhjetor 2000, nëpërmjet nënshkrimit ose ndonjë mënyre tjetër.

8. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë që pason ditën e pranimin të tij.

9. Ky Protokoll do të depozitohet tek Drejtori i Përgjithshëm i OBT-së. Drejtori i Përgjithshëm i OBT-së do t'i japë menjëherë çdo anëtar të OBT-së dhe Shqipërisë një kopje të vërtetuar të këtij Protokolli dhe një njoftim lidhur me pranimin në vijim të paragrafit 7.

10. Ky Protokoll do të regjistrohet në përputhje me dispozitat e Nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Gjenevë ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit korrik të vitit dy mijë, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, duke qenë secili tekst autentik, përveç faktit që ndonjë Skedul i aneksuar mund të specifikojë që është autentik në një ose më shumë prej këtyre gjuhëve.

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJEVE TË REZULTATEVE
TË RAUNDIT TË URUGUAIT PËR NEGOCIATAT SHUMËPALËSHE TREGTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshjet e rezultateve të raundit të Uruguait për negociatat shumëpalëshe tregtare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2720, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

**L I G J
Nr.8650, datë 28.7.2000**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8114, DATË 28.3.1996
“PËR SPORTIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8114, datë 28.3.1996 “Për sportin” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“Organizatrat sportive vendore janë klubet ose/dhe shoqatat sportive, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre sportive në një bashki ose komunë të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Shteti ka për detyrë të nxisë zhvillimin e sportit për të gjithë dhe ndërtimin e mirëmbajtjen e

infrastrukturës sportive.

Shteti financon veprimtaritë sportive të organizatave sportive kombëtare dhe krijon lehtësira fiskale për veprimtarinë ekonomike të tyre, në përputhje me ligjin.

Shteti financon veprimtarinë sportive të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të federatave sportive dhe klubeve sportive, nëpërmjet financimit të projekteve të paraqitura prej tyre, brenda fondeve buxhetore të miratuara me ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për Ministrinë Përgjegjëse për Sportin.

Financimi buxhetor i organizatave sportive zbatohet vetëm sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministri i Financave dhe Ministri Përgjegjës për Sportin.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqatë ose si shoqëri tregtare.

Klubi ose shoqata sportive ndërtohet dhe funksionon si shoqatë sportive në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Klubi sportiv mund të transformohet nga shoqatë sportive në shoqëri tregtare vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të tij, në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin.

Vetëm klubet sportive që funksionojnë si shoqëri tregtare kanë të drejtë të kenë si qëllim fitimin në veprimtarinë e tyre sportive.

Një shoqatë sportive ka të drejtë të jetë ortak në krijimin e një shoqërie. Shoqëria e krijuar me ortak me një shoqatë sportive, quhet shoqëri sportive mikse dhe regjistrohet në federatën përkatëse. Pjesa e fitimit e shoqatës si ortak në shoqërinë sportive mikse investohet përsëri në veprimtarinë sportive të shoqërisë.

Kur shoqëria tregtare sportive mikse merr emrin e shoqatës sportive që hyn si ortak, ky emër mbetet pronë e shoqatës sportive në rastin e shpërbërjes së shoqërisë ose të daljes së shoqatës nga shoqëria tregtare.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2721, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8651, datë 28.7.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 “PËR
SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.
8508, DATË 7.7.1999; NR.8519, DATË 30.7.1999; NR. 8552, DATË 18.11.1999 DHE NR. 8581,
DATË 17.2.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999; nr. 8552, datë 18.11.1999 dhe nr. 8581, datë 17.2.2000, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 2 pika 13 ndryshohet si vijon:

“13.Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radio e televizive”

Neni 2

Neni 6 shkronja “k” titulli ndryshohet:

“k) Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radio e televizive”

Në fund të shkronjës “k”, pas “...përsëritës 100 000 (njëqind mijë) lekë” shtohet:

“Për lidhjet me studiot

Sistem në brezin mbi 1000 MHz

a) analog:

- Për çdo kanal me gjerësi deri 1 MHz	30 000 lekë në vit
- Për çdo kanal me gjerësi deri 10 MHz	40 000 lekë në vit
- Për çdo kanal me gjerësi mbi 10 MHz	60 000 lekë në vit

b) dixhital:

- Për kapacitet deri 128 kb/s	5 000 lekë në vit
- Për kapacitet deri në 2mb/s	20 000 lekë në vit
- Për kapacitet deri 8 mb/s	30 000 lekë në vit
- Për kapacitet deri 34 mb/s	40 000 lekë në vit
- Për kapacitet mbi 34 Mb/s	50 000 lekë në vit”

Neni 3

Neni 9 shkronja “j” ndryshohet:

“j).Për taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT).”

Neni 4

Lidhjet e ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” ndryshohen si vijon:

Në lidhjen nr.7 pika v, titulli ndryshohet:

“v.Shërbimi fiks për operatorët e telekomunikacioneve”
Lidhja 10 e ligjit ndryshon sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.2722, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIDHJA NR.10

TAKSA MUJORE E SOLIDARITETIT PËR RENDIN DHE MBROJTJEN

	Lekë
1. Subjektet shtetërore të regjistruara në TVSH	100 000
2. Filialet e subjekteve shtetërore të regjistruara në TVSH	5 000
3. Subjektet me kapital të përbashkët (shtet-privat)	50 000
4. Subjektet private të regjistruara në TVSH	5 000
5. Filialet e subjekteve private të regjistruara në TVSH që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë qendrës administrative të subjektit kryesor	2 000
6. Biznesi i vogël në qytet	1 000
Përfshihen nga pagesa e taksës së solidaritetit të gjitha subjektet e biznesit të vogël që zhvillojnë tregti ambulante në tregjet e miratuara nga organet e pushtetit vendor.	
7. Biznesi i vogël në fshat	500

L I G J **Nr.8654, datë 31.7.2000**

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 108-112 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I:**

Neni 1

Bashkia e Tiranës përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh me status

të veçantë.

Neni 2

1. Në Bashkinë e Tiranës funksionojnë:
 - a) Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë.
 - b) Kryetari i Bashkisë si organi ekzekutiv i Bashkisë.
2. Këshilli Bashkiak dhe Kryetari zgjidhen drejtpërdrejt nga populli me zgjedhje të lira, vetjake, të barabarta dhe të fshehta, sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore.
3. Këshilli Bashkiak dhe Kryetari gëzojnë të drejtat, kryejnë funksione dhe i ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara për bashkitë në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me përjashtim të detyrave të përcaktuara për njësitë bashkiake në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 3

1. Në Bashkinë e Tiranës funksionojnë 11 njësi bashkiake të qeverisjes vendore, të cilat kanë statusin e përcaktuar në këtë ligj.
2. Në njësinë bashkiake, organet përfaqësuese janë:
 - a) Këshilli i njësisë bashkiake si organ përfaqësues i njësisë bashkiake.
 - b) Kryetari si organ ekzekutiv i njësisë bashkiake.
3. Organet e njësisë bashkiake zgjidhen sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
4. Këshilli dhe kryetari i njësisë bashkiake ushtrojnë funksionet, të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 4

Në përputhje me ligjin, si dhe për interes publik, organet e Bashkisë së Tiranës nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra, për bashkërendimin e veprimtarive në njësitë bashkiake në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Neni 5

Numri i anëtarëve të këshillit të njësisë bashkiake përcaktohet nga Prefekti në varësi të numrit të banorëve, në bazë të të dhënave të zyrave përkatëse të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit në të cilin zhvillohen zgjedhjet, sipas ndarjes që vijon:

deri në 30 000 banorë	19 anëtarë
nga 30 000 në 50 000 banorë	23 anëtarë
mbi 50 000 banorë	27 anëtarë

Neni 6

1. Njësia bashkiake miraton, zbaton dhe administron buxhetin e vet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Buxheti i njësisë bashkiake krijohet nga të ardhurat e veta dhe nga pjesa që financohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, sipas përcaktimit që bën Këshilli Bashkiak.
3. Të ardhurat e veta sigurohen nga tarifat e shërbimeve që kryen njësia për funksionet që ka, sipas niveleve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, nga dhuratat, ndihmat, gjobat e të tjera, të përcaktuara në ligjin përkatës.
4. Fondet e kushtëzuara nga Bashkia u caktohen njësive bashkiake në përputhje me funksionet, të

drejta dhe detyrat që i jepen njësisë bashkiake, sipas këtij ligji, si dhe për plotësimin e funksioneve dhe të përgjegjësisë të deleguara nga Këshilli Bashkiak.

Neni 7

Këshilli i njësisë bashkiake organizon kontrollin e brendshëm financiar. Çdo njësi bashkiake i nënshtrohet kontrollit të Bashkisë së Tiranës dhe kontrollit të jashtëm financiar, sipas rregullave të përcaktuara me ligj.

Neni 8

- Këshilli i njësisë bashkiake ka këto të drejta dhe detyra:
- a) Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
 - b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.
 - c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit.
 - ç) Miraton buxhetin e njësisë bashkiake dhe ndryshimet e tij.
 - d) Vendors për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të përgjegjësisë të veta.
 - dh) Vendors për dhënien dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të njësisë bashkiake.
 - e) Miraton norma e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e punës, për kryerjen e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik, në përputhje dhe duke respektuar normat dhe kriteret e caktuara nga Këshilli Bashkiak.
 - ë) Administron parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara, që i përkasin njësisë bashkiake.
 - f) Administron tregjet publike dhe rrjetin e tregtisë që i përkasin njësisë.
 - g) Administron kopshtet, shkollat tetëvjeçare dhe të mesme.
 - gj) Administron çerdhet dhe ambulancat.
 - h) Përgjigjet për ruajtjen e vlerave dhe zhvillimin e veprimtarive kulturore.
 - i) Administron këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë në territorin e vet.
 - j) Vendors për shpërndajen e fondeve të ndihmës ekonomike.
 - k) I propozon Këshillit Bashkiak strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së njësisë bashkiake dhe të institucioneve në varësi të saj, numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblyerjes të punonjësve, si dhe të personave të zgjedhur ose të emëruar.
 - l) I propozon Këshillit Bashkiak për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë bashkiake.
 - ll) I propozon Këshillit Bashkiak për dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për persona, brenda juridiksionit të vet, si dhe për emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë në juridiksionin e vet.
 - m) Kryen detyrat e funksionet që i delegohen nga Këshilli Bashkiak.

Neni 9

- Kryetari i njësisë bashkiake ka këto detyra dhe përgjegjësi:
- a) Zbaton aktet e këshillit të njësisë bashkiake.
 - b) Merr masa për përgatitjen e mbledhjes së këshillit, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë.
 - c) Raporton në këshill për gjendjen ekonomike e financiare sa herë kërkohet nga këshilli, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
 - ç) Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për problemet që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrat e njësisë.
 - d) Emëron dhe shkarkon zëvendëskryetarin e njësisë bashkiake.
 - dh) Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së vet, përveç rasteve kur parashikohet

ndryshe në ligj.

e) Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar njësisë bashkiake.

ë) Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve sociale, kulturore e sportive.

f) Kthen për rishqyrtim në këshill, jo më shumë se një herë, vendimet e këshillit të njësisë, kur vëren së ato çenojnë interesat e bashkësisë.

g) Njofton Kryetarin e Bashkisë për të gjitha shkeljet e akteve, ligjore e nënligjore, që vërehen në njësinë bashkiake, zgjidhja e të cilave varet nga Bashkia.

Neni 10

Këshilli i njësisë bashkiake dhe Kryetari, për përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të këtij ligji, marrin vendime, urdhëresa dhe urdhra. Vendimet urdhëresat dhe urdhrat i dërgohen për verifikim ligjor Prefektit dhe për njoftim Kryetarit të Bashkisë.

Neni 11

Krijimi dhe mënyra e organizimit të këshillit të njësisë bashkiake dhe e përcaktimit të Kryetarit bëhen në përputhje me kreun VI dhe VII të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me ndryshimet e mëposhtme:

a) Për zgjedhjet e vitit 2000, përjashtimisht, thirrja e mbledhjes së parë të këshillit të njësisë bashkiake bëhet nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, brenda 40 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve.

b) Mbledhja e këshillit të njësisë bashkiake, përveç sa parashikohet në nenin 31 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, mbledhet edhe jashtë radhe me kërkesën e Prefektit.

c) Shpërndarja e këshillit të njësisë bashkiake, si dhe shkarkimi i Kryetarit të njësisë bashkiake bëhet sipas përcaktimeve në nenet 38 dhe 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

ç) E drejta për ankim ushtrohet sipas nenit 115 të Kushtetutës.

Neni 12

Këshilli dhe kryetari i njësisë bashkiake e nisin veprimtarinë nga data e konstituimit të tyre.

Neni 13

Organet e njësisë bashkiake dhe administrata e tyre përfitojnë të drejta si ato të bashkive të tjera të vendit, përsa i përket trajtimit të tyre.

Neni 14

Kreu III i ligjit nr. 7605, datë 15.9.1992, “Për nënndarjet në bashki e komuna dhe organizimin e funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2724, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep

Meidani.

L I G J
Nr.8655, datë 31.7.2000

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8410, DATË 30.9.1998 “PËR RADION DHE
TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit administron spektrin e radiofrekuencave të caktuara për transmetime radio e televizive.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit administron spektrin e radiofrekuencave të caktuara për shërbimet fikse dhe lëvizëse, që përdoren nga operatorët radiotelevizivë publikë e privatë për lidhje radiorele, radiomikrofona dhe radiokamera, sipas planit kombëtar të radiofrekuencave të miratuar nga Këshilli i Ministrave.”

Në po këtë nen, pika 20 ndryshohet si vijon:

“Kontrollon cilësinë e marrjes së sinjaleve në zonat e licencuara dhe kërkon zgjidhje për ankesat e publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve radiotelevizive.”

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Burimet e financimit të KKRT-së janë:

- të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave;
- të ardhurat nga pagesat vjetore të licencës;
- të ardhurat nga përpunimi i kërkesave për licencim;
- të ardhurat nga taksat për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të caktuara në ligjet fiskale;
- financime nga buxheti i shtetit;
- dhurimet.

Tarifat për marrjen dhe rinovimin e licencave, tarifat vjetore për licencat, të ardhurat që sigurohen nga përpunimi i kërkesave për licencim, kriteret dhe mënyra e kryerjes së tyre caktohen nga KKRT-ja.”

Neni 3

Neni 19, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Licenca autorizon shfrytëzimin e rrjeteve të trasmetuesave me shtrirje kombëtare ose lokale dhe

përcakton frekuencat e punës, fuqinë, vendvendosjen, zonën e mbulimit, si dhe elemente të tjera që përcaktohen në këtë ligj dhe në rregulloret e KKRT-së.”

Neni 4

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Licencat janë dy llojesh: kombëtare dhe lokale.

Për transmetime televizive tokësore jepen dy licenca private kombëtare.

Për transmetime radio me modulim në frekuencë jepen katër licenca private kombëtare.

Licencat për transmetim televiziv ose radio në shkallë kombëtare u jepen shoqërive anonime që themelohen me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë me synim ekskluziv veprimtarinë radiotevizive. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence për transmetim televiziv ose radio, janë nominative.

Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë.

Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio, janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e mbajtësve të aksioneve.

Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri televizive ose radio kombëtare, nuk lejohet të ketë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, aksione në një shoqëri të dytë televizive ose radio kombëtare, si dhe nuk i lejohet të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje lokale.

Licencat për transmetim televiziv ose radio lokale me modulim në frekuencë u jepen personave juridikë e fizikë dhe organizatave jofitimprurëse të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Të njëjti subjekt nuk i jepet licencë për më shumë se dy zona transmetimi lokal. Licenca për transmetim lokal në zonat urbane me mbi 200.000 banorë nuk u jepet personave fizikë.

I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv lokal mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje lokale.

I njëjti subjekt që zotëron një licencë për radio lokale mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim televiziv lokal.

Mbajtësi i licencës për transmetim televiziv ose radio kombëtare duhet të realizojë mbulimin e mbi 70 për qind të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh ky mbulim duhet të përfshijë jo më pak se 90 për qind të territorit dhe jo më pak se 90 për qind të popullsisë së Shqipërisë.

Mbajtësi i licencës për transmetim televiziv ose radio lokale duhet të realizojë mbulimin e zonës së caktuar në licencë sipas parametrave teknikë të përcaktuar nga KKRT-ja.

Me termin “transmetim televiziv ose radio lokale”, sipas këtij ligji nënkuptohet mbulimi me sinjal televiziv ose radio nga operatorët televizivë ose radio të licencuar, si të tillë, i territorit të komunave, bashkive, deri në hapësirën administrative të dy prefekturave, kur ato formojnë një entitet gjeografik dhe që ofrojnë burime të mjaftueshme financiare për prodhim dhe transmetim programesh televizive ose radio.

I ndalohet huazimi i emrit, në çdo lloj mënyre, çdo subjekti fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që kandidohet për marrjen e një licence për veprimtari radio ose televizive.”

Neni 5

Në nenin 23, pika 5 ndryshohet si vijon:

“5.deklaratën e aplikuesit se do të zbatojë ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit” , legjislacionin plotësues në fuqi, si dhe marrëveshje dhe kontratë me shoqëritë e autorit.”

Neni 6

Në nenin 35, paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Programet radiotevizive respektojnë kufizimet e parashikuara me ligj, ato të nenit 10 të

Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” dhe të kreut “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.”

Neni 7

Neni 70, ndryshohet si vijon:

“Neni 70

RTSH-ja përfshin në transmetimet e saj:

- 2 programe televizive kombëtare;
- 2 programe radiofonike kombëtare;
- 1 program radiofonik në gjuhë të huaja dhe për bashkatdhetarët në AM;
- programet e qendrave radiotelevizive rajonale;
- 1 program satelitor radioteleviziv.”

Neni 8

Në nenin 122, pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Ritransmetim të programeve të destinuara për qarqe të mbyllur televizivë si hotele, pensione, rezidenca turistike, fshatra turistike, anije, tragete, spitale, kinema, teatro dhe diskoteka.”

Neni 9

Neni 126 ndryshohet si vijon:

“Neni 126

**Rregullat e shpërndarjes me kabëll
të programeve radiotelevizive**

Për të realizuar transmetim cilësor të zërit dhe të figurës për pajtimtarët, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bashkëpunim me operatorët e pavarur ose publikë të telekomunikacionit, që disponojnë rrjete kablore, përcakton rregullat dhe mënyrat e shpërndarjes së programeve radiotelevizive.”

Neni 10

Neni 128 ndryshohet si vijon:

“Neni 128

Përsëritësat e programeve të huaja televizive

Përsëritësat janë aparatura transmetimi, të përbëra nga marrësat satelitorë ose antena marrëse tokësore, nga përsëritës televizivë ose radio, nga transmetues televizivë ose radio, të destinuar për marrjen dhe ritransmetimin e plotë, të pandryshuar dhe të njëkohshëm në efir brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të programeve televizivë ose radio që transmetohen nga stacionet e huaja në rrugë tokësore ose satelitore.”

Neni 11

Në nenin 129, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Në caktimin e kanaleve dhe frekuencave për përsëritësat kanë përparësi kërkesat për kanale dhe

frekuenca të subjekteve publike e private të licencuara.”

Neni 12

Në nenin 130, shtohet pika 6 me kete përmbajtje:

“6. Kushte të tjera të përcaktuara nga KKRT-ja në rregulloren e saj për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio në Shqipëri.”

Neni 13

Në kreun XII, pas nenit 137 shtohen 5 nene me këtë përmbajtje:

“Neni 137/1

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit kryhet nga specialistë të administratës së KKRT-së. Këta specialistë pajisen me dokument të posaçëm identifikimi dhe quhen inspektorë.

Ata kryejnë inspektim në mjediset ku i licencuari zhvillon veprimtarinë e tij edhe pa e njoftuar paraprakisht atë, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të kushteve të licencës dhe të rregulloreve të miratuara nga KKRT-ja.

I licencuari nuk ka të drejtë t’i ndalojë inspektorët për të kryer inspektim. Ai është i detyruar të bashkëpunojë me ta dhe t’u japë informacion, kur ata e kërkojnë një gjë të tillë.

Inspektori, kur nevojitet ekspertizë e veçantë, mund të marrë ekspertë.

“Neni 137/2

Blokim i pajisjeve

Inspektorët bllokojnë dhe mbyllin me vulosje pajisjet, kur për përdorimin e tyre nuk është marrë licencë, kur ato nuk janë të miratuara ose kur nuk plotësohen kushtet e licencës.

Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit dhe më pas i jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet Këshillit Kombëar të Radios dhe Televizionit dhe subjektit të mësipërm, kalon në buxhetin e shtetit.

“Neni 137/3

Kundërvajtjet administrative

Kur inspektorët e KKRT-së vërtetojnë se i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara nga KKRT-ja, kanë të drejtë:

1. të vendosin gjobë, në zbatim të nenit 137/4 të këtij ligji dhe të kërkojnë nga i licencuari marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj;
2. t’i propozojnë KKRT-së ndalimin e veprimtarisë së të licencuarit;
3. t’i propozojnë KKRT-së pezullimin e përkohshëm të licencës, reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës ose heqjen e saj.

KKRT-ja, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me pikat “2” dhe “3” të këtij neni:

- a) paralajmëron të licencuarin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;
- b) pezullon përkohësisht licencën e dhënë dhe redukton kohën e vlefshmërisë së licencës; heq licencën sipas nenit 34 të këtij ligji.

Për t’i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së

këtij vendimi.

Nëse edhe pas dëgjimit të të licencuarit, KKRT-ja e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje. KKRT-ja e boton vendimin në Fletoren Zyrtare në numrin më të afërt të saj dhe në Buletinin e vet.

KKRT-ja ndjek zbatimin e vendimit.

KKRT-ja vendos sanksionet e parashikuara në ligj, jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

“Neni 137/4

Gjobat

Shkeljet e mëposhtëme, të kryera nga të licencuarit, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë nga 20.000 deri 200.000 lekë për rastet kur:

a) nuk siguron kohë të mjaftueshme në transmetim për informacionet, objekt i nenit 39 të këtij ligji;

b) eliminon, para afatit të përcaktuar në nenin 42 të këtij ligji, regjistrimin dhe arkivimin e lajmeve;

c) eliminon, para afatit të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, regjistrimin e reklamave.

2. Me gjobë nga 60.000 deri 1.000.000 lekë për rastet kur:

a) nuk respektohen në transmetim kufijtë kohorë dhe territorialë të përcaktuara në kushtet e licencës;

b) nuk respektohen detyrimet e neneve 50, 51, 52, 53, 55, 56, 57 dhe 58 të këtij ligji për transmetimin e reklamave;

c) nuk respektohen detyrimet e neneve të kreut VII të këtij ligji për sponsorizimet;

ç) nuk respekton kushtet e licencës përsa i përket programeve të prodhuara në vend;

d) nuk njofton për ndryshimet që kanë ndodhur në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë;

dh) ndalohet hyrja e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet radiotelevizive të të licencuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara nga ata;

e) shkaktohen interferenca ndaj të një licencuari tjetër si rezultat i mosrespektimit të kushteve teknike në transmetim.

3. Me gjobë nga 500.000 deri 1.500.000 lekë për rastet kur:

a) kryen transmetime në një frekuencë tjetër të paautorizuar;

b) kryen transmetime me fuqi rrezatuese më të madhe se ato të autorizuar;

c) transmeton nga vende të ndryshme nga ato të shënuara në licencë;

ç) transmeton programe të ndaluara me ligj, të përcaktuara si të tilla në nenin 38 të këtij ligji;

4. Me gjobë deri në 4 milionë lekë për rastet kur një person instalon pajisje televizive ose radiojeje, duke dalë në transmetim në efir me figurë ose me zë pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë nga inspektori përkatës bëhet ankim në KKRT-ja brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dhënies së gjobës.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative” me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme.

Gjoha është titull ekzekutiv që vilet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.

“Neni 137/5

Bashkëpunimi me organet e tjera

Për ushtrimin e të drejtave që burojnë nga ky ligj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit duhet të mbështetet nga autoritetet publike vendore dhe ato policore.

Ngarkohet Policia Tatimore në ekzekutimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, lidhur me gjobat, sanksionet dhe heqjen e licencave.”

Neni 14

Çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2730, datë 7.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8656, datë 31.7.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8436, DATË 28.12.1998 “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8546, DATË 5.11.1999

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8436, datë 28.3.1996 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/a me këtë përmbajtje:

“Neni 4/a
Viti gjyqësor

1. Viti gjyqësor fillon më datën 10 maj të çdo viti kalendarik dhe përfundon më datën 9 maj të vitit pasardhës.
2. Ceremonia e përurimit të vitit të ri gjyqësor bëhet në formë publike dhe solemne. Në këtë ceremoni marrin pjesë gjyqtarë, prokurorë, funksionarë të Ministrisë së Drejtësisë, të ftuar nga Gjykata Kushtetuese, Zyra e Avokatit të Popullit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë,

si dhe nga institucione ose subjekte të tjera, veprimtaria e të cilëve lidhet me fushën e drejtësisë dhe gjyqësorit.

3. Ditën e përrimit të vitit të ri gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Drejtësisë bëjnë publike Rezolutën e Përbashkët, lidhur me administrimin dhe problemet në fushën e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, në të cilën, ndër të tjera, jepen edhe orientime dhe rekomandime për veprimtarinë në vitin e ri gjyqësor.

4. Kopje e Rezolutës së Përbashkët, lidhur me administrimin dhe problemet në fushën e drejtësisë, i dërgohet Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 2

Në fillim të nenit 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Gjykata të shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat e krimeve të rënda dhe gjykatat ushtarake.”

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Gjykatat e apelit gjykojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore.

Gjykatat e apelit gjykojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatave për krimet e rënda.”

Neni 4

Në fund të nenit 10 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Krimet e rënda gjykohen nga pesë gjyqtarë.”

Neni 5

Në nenin 11 në paragrafin e parë bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fjalinë e parë, fjalët “Gjykatat e shkallës së parë” zëvendësohen me fjalët “Gjykatat e rretheve gjyqësore”.

- Pas fjalisë së parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Gjykatat për krimet e rënda organizohen dhe funksionojnë në një a më shumë rrethe gjyqësore.”

Neni 6

Në nenin 14/b, në fund të pikës së dytë, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Kancelari përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore të njëjtë me atë të gjyqtarit të gjykatës përkatëse ku ushtron funksionet e tij.”

Neni 7

Në nenin 17 në paragrafin e dytë, pas fjalëve “ngarkesën në punë”, shtohen fjalët “, verifikimin dhe evidentimin e pasurive të deklaruara, të çështjeve të pajtueshmërisë së veprimtarisë dhe sjelljes së gjyqtarëve,”

Neni 8

Në nenin 24 në pikën 1 fjalët “Gjyqtarët e gjykatës së apelit” zëvendësohen me fjalët “Gjyqtarët e

gjykatave për krimet e rënda dhe të gjykatave të apelit”.

Neni 9

Pas nenit 25 shtohet neni 25/a me këtë përmbajtje:

“Për plotësimin e vendeve vakante dhe emërimin në detyrë të specialistëve psikologë, që bëjnë pjesë në trupat gjykues për gjykimin e të miturve, zbatohen procedurat e parashikuara në nenet 21, 22 dhe 23 të këtij ligji.

Specialisti psikolog përfiton 80 për qind të pagës së gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku ushtron funksionet e tij, si dhe leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh.”

Neni 10

Pas nenit 30 shtohet neni 30/a me këtë përmbajtje:

“Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të Ministrit dhe strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto struktura njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë.

Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurrs.”

Neni 11

Pas nenit 38 shtohet neni 38/a me këtë përmbajtje:

“Neni 38/a

Ruajtja e veçantë vetjake për familjen dhe pronën e gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda, si dhe trajtimi financiar i posaçëm i tyre, rregullohen me ligj.”

Neni 12

Dispozitë kalimtare

Koha e fillimit të veprimtarisë së gjykatave për krimet e rënda caktohet me ligj.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2731, datë 7.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8657, datë 31.7.2000

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.1, DATË 14.7.2000 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8554, DATË 10.12.1999 “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË

VITIT 2000””

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 14.7.2000 “Për një ndryshim në ligjin nr.8554, datë 10.12.1999 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2000””, sipas tekstit të mëposhtëm:

Neni 1

Në ligjin nr.8554, datë 10.12.1999 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2000”, fondet e miratuara për Ministrinë e Financave në buxhetin e vitit 2000, në zërin “Kostoja e ristrukturimit të bankave”, pakësohen me 800 (tetëqind) milionë lekë.

Neni 2

Ky fond të përdoret për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja, mesatarisht 10 për qind e pagave dhe 15 për qind e pensioneve, nga të cilat 375 milionë të përdoren për pagat dhe sigurimet shoqërore (kontribut i punëdhënësit) dhe 425 milionë për rritjen e pensioneve.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave të bëjë shpërndarjen e fondeve për çdo ministri, institucion shtetëror dhe për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.”

Shpallur me dekretin nr.2725, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8658, datë 31.7.2000

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.2, DATË 27.7.2000 “PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR PARTITË POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E PUSHTETIT VENDOR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 27.7.2000 “Për miratimin e fondit për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor”, sipas tekstit të mëposhtëm:

“Neni 1

Në mbështetje të nenit 139 paragrafi 2 i “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, i miratuar me ligjin nr.8609, datë 8.5.2000, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jepet fondi prej 40 milionë lekësh për financimin e partive politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.

Neni 2

Ky fond të financohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i miratuar për vitin 2000.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.”

Shpallur me dekreten nr.2726, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

V E N D I M
Nr. 434, datë 4.8.2000

**PËR STREHIMIN E FAMILJEVE TË INVALIDËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE, QË BANOJNË NË SHTËPI, ISH-PRONË PRIVATE, DHE PËR
FAMILJE TË PASTREHA TË INVALIDËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, të nenit 7, të ligjit nr.7652, datë 25.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Sistemimin me banesa të familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qytetit të Tiranës, në rrugën “Don Bosko”, nga fondet e banesave të Entit Kombëtar të Banësive. Shpërndarja e tyre do të bëhet në bazë të listës (bashkëlidhur tabela), të dërguara nga Bashkia e Tiranës.

2. Sistemimin me banesa të familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qytetit të Durrësit në banesën tip 82/2, sek 15, me 15 apartamente, blloku në veri të stadiumit, nga fondet e banesave të Entit Kombëtar të Banësive. Shpërndarja e tyre do të bëhet në bazë të listës (bashkëlidhur tabela), të dërguar nga bashkia e Durrësit.

3. Fondi prej 27 500 mijë lekësh, për blerje banesash në tregun e lirë, për familjet e pastreha të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për qytetet Korçë, Shkodër, Shijak, Kavajë, Vlorë, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Punëve Publike, në zërin “Fondi i investimeve”. Shpërndarja e tyre do të bëhet sipas listës (bashkëlidhur tabela), të dërguar nga bashkitë

përkatëse.

4. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave, të shoqëruara me strukturat përkatëse, vë në dispozicion të secilit qytetar të pastrehë, invalid lufte, shumën limit të përfitimit falas.

-për apartamente 1+1 shumën 1 707 milionë lekë

-për apartamentet 2+1 shumën 2 137 milionë lekë

-për apartamente 3+1 shumën 2 482 milionë lekë

Këto shuma do të indeksohen me vlerën e koeficientit “k”.

5. Fondi prej 18 600 000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh të kalojë, në llogari të veçantë, në Entin Kombëtar të Banesave, për tu përdorur për familjet e pastreha të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

6. Përdorimi i fondeve të mësipëme do të bëhet sipas radhës dhe përparësive, të përcaktuara nga shoqata e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

7. Enti Kombëtar i Banesave, para lidhjes së kontratave, të bëjë verifikimin e dokumentacionit në bazë të të cilit janë hartuar listat dhe në çdo rast shkeljeje të kritereve të caktuara të mos bëjë lidhjen e kontratës së shitblerjes me qytetarin.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave, organet përkatës të pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

LISTA EMËRORE E INVALIDËVE TË LANÇ
DHE STRUKTURA E APARTAMENTEVE QË PËRFITOJNË

TIRANË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Bexhet	Mema	1+1
2.	Veiz	Pipa	1+1
3.	Hajro	Haxhia	2+1
4.	Islam	Poçi	1+1
5.	Koço	Koçi	2+1
6.	Liri	Belishova	2+1
7.	Luan	Leka	2+1
8.	Mihallaq	Papa	1+1
9.	Neki	Shima	1+1
10.	Nexha (Ganimet)	Hysi	1+1
11.	Njiazi	Cepani	2+1
12.	Pajo	Islami	1+1
13.	Safet	Kurti	3+1
14.	Servet	Hajdari	1+1
15.	Shpend	Dega	2+1
16.	Skënder	Peza	2+1
17.	Sulo (Sabrie)	Kozeli	1+1
18.	Tare	Çela	2+1

DURRËS

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Jaup	Stepa	1+1
2.	Memo	Hasanaj	3+1
3.	Gaqo	Rado	1+1
4.	Rexhep	Baçe	1+1
5.	Xhemal	Zenelaj	1+1
6.	Vlash	Kalavaçi	1+1

SHIJAK

Nr	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Sulejman	Zahiri	1+1

SUKTH

Nr	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Rahman	Patova	3+1

SHKODËR

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Baftjar	Xhindi	1+1

KAVAJË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Bejo	Gjoni	2+1
2.	Aqif	Ndreu	3+1

VLORË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Arif	Halilaj	1+1

KORÇË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Marko	Poda	1+1
2.	Hajredin	Qazimllari	2+1
3.	Polikron	Qyti	2+1

U dorëzua për shtyp më 7.8.2000
Doli nga shtypi më 7.8.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë